

## Llogari Rrjedhëse për Klientët Individë

### Informacion rreth Bankës

#### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr.: "Ismail Qemali", Nr. 27,  
Kutia postare 8319; 1001 Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762  
Website: [www.intesasanpaolobank.al](http://www.intesasanpaolobank.al)

### Karakteristikat dhe Rreziqet e Llogari Rrjedhëse për klientët individë

#### Karakteristikat e Llogarisë Rrjedhëse

Llogaria rrjedhëse është një llogari, në të cilën klienti mund të kryej në çdo kohë transaksionet që dëshiron. Një llogari rrjedhëse mund të hapet në monedhat: LEK; EUR; USD; GBP dhe CHF. Shuma fillestare për të hapur një llogari rrjedhëse është LEK 1,000; 10 EUR/ USD/ GBP/ CHF. Llogaria rrjedhëse është një llogari ku klienti mund të:

- Depozitohet, të vendosë para në bankë dhe
- Tërheqë, të marrë para.

Mënyrat për të depozituar në llogarinë rrjedhëse:

- Depozitimi i parave (cash) i monedhave dhe kartëmonedhave në Degë;
- Transferte bankare nga jashtë;
- Depozitimi i një çeku;
- Pagesa elektronike;
- Depozitim në ATM

Mënyrat për tërheqje nga llogaria rrjedhëse:

- Tërheqje parash (cash) në sportelet e bankës;
- Tërheqje nëpërmjet një çeku;
- Tërheqja e parave nga një makinë sportel e automatizuar (ATM) nëpërmjet kartës;
- Blerje e mallrave me një kartë debiti (POS);
- Vendosja e një urdhër pagese periodike ose debitimi automatik nga llogaria;
- Etj.

Llogaria rrjedhëse është një llogari për përdorim të përditshëm. Ajo mund të aksesohet individualisht, ose nga dy ose më shumë persona, më vete ose së bashku. Llogaria rrjedhëse individuale mund të krijohet për dy ose më shumë persona së bashku dhe kjo quhet një llogari e përbashkët. Klienti duhet të dakordësojnë në lidhje me të drejtat që do të ketë secili prej tyre në llogarinë rrjedhëse.

Dokumentacioni që kërkohet për të hapur një llogari është një kartë identiteti/ pasaportë e vlefshme.

Me llogarinë rrjedhëse lidhen shumë produkte/ dhe shërbime nëse klienti do të aplikojë për një Kartë Debiti, Internet Banking, Debitim automatik, Pagesë page, Urdhër Pagese Periodike, Njoftim me SMS, Paradhënie bankare, Kredi, POS, Depozitë me afat, Bono thesari, Transferte, Cash, Pagesë me çek, Transferte në mbërritje, Trasnferte në nisje, etj."

#### Tregu i synuar

Tregu i synuar i llogarisë rrjedhëse janë të gjithë klientët rezidentë dhe jo-rezidentë të cilët duhet të kryejnë transaksione cash dhe jo-cash:

- Transaksionet cash përfshijnë të gjitha debitimet dhe kreditimet cash, të cilat kryhen pranë sporteleve të bankës (arkëtarët) dhe në makinat sportel të automatizuar ATM (duke përfshirë ATM të bankave të

tjera).

- Transaksionet jo cash përfshijnë të gjitha transaksionet përmes të cilave debitohet ose kreditohet llogaria rrjedhëse, jo cash, si:
  - Transfertat e brendshme (brenda Bankës);
  - Transfertat në mbërritje;
  - Transfertat në nisje;
  - Depozita përmes çekut, etj.

#### Dokumentet e nevojshme

- Mjet i vlefshëm identifikimi: Pasaportë/Kartë identiteti
- Forma e aplikimit
- Kontrata e Llogarisë Rrjedhëse
- Dokumentacioni i FATCA & CRS
- Specimen i firmës

#### Rreziqet e Llogarisë Rrjedhëse

1. Në rast se llogaria rrjedhëse është në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e kursit të këmbimit;
2. Nëse klienti ka vetëm një llogari në bankë dhe e mbyll atë brenda 3 muajve, klienti do të paguajë një komision. Klienti duhet të mbyllë të gjitha produktet që lidhen me llogarinë rrjedhëse në rast se dëshiron të mbyllë llogarinë;
3. Nëse llogaria nuk përdoret për një periudhë për më shumë se 12 muaj, statusi i llogarisë ndryshon në llogari e fjetur. Klienti duhet të kryej një transaksion për të ndryshuar statusin e llogarisë;
4. Nëse llogaria nuk ka gjendje dhe kalon në balancë negative për shkak të komisionit të mirëmbajtjes së llogarisë (oseprodukteve të lidhura me të) klienti është i detyruar t'i paguajë Bankës të gjithë gjendjen debitore.
5. Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimine depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100% (përqind), por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:				
<b>Shpenzimet fikse mujore</b>				
Komisione për Mirëmbajtje Llogarie	Për llogaritë individuale		Për llogaritë e përbashkëta	
	150 LEK/ 1.5 EUR/USD/GBP/CHF		200 LEK/ 2 EUR/USD/GBP/CHF	
Tarifa mujore e shërbimit për kartë debiti	Visa Inspire	Visa Classic	MC Standard	MC Gold
	150 LEK	2 USD	1.50 EUR	2.50 EUR
Komision per Software Token	Falas			
Komisioni i lëshimit për Hardware Token	700 LEK/ përdorues			
Komision per Sherbimin Bankar Dixhital	Falas			
Njoftim përmes SMS	150 LEK/ muaj			
<b>Shpenzime të ndryshme</b>				
Nxjerrje llogarie*	100 LEK nxjerrje llogarie për muajin aktual; 200 LEK nxjerrje llogarie për vitin aktual; 500 LEK nxjerrje llogarie për vite të mëparshme			
	* Klienti gëzon të drejtën që 1 herë në vit të marrë falas printimin e levizjes së llogarisë/ve			
Dërgimi i levizjeve të llogarisë në mënyrë elektronike	Falas			
Dërgimi i levizjeve të llogarisë në adresën e klientit	100 LEK / zarf			

Transaksione në ATM të Intesa Sanpaolo Bank Albania në Shqipëri		Falas
Tërheqje parash në sportelet e Bankës nga llogaria rrjedhëse	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 150 LEK për shumat deri në 75,000 LEK <i>(vetëm për tërheqjet në LEK)</i></li> <li>• Falas për shumat deri në 75,000 LEK <i>(për tërheqjet në të gjitha monedhat të ndryshme nga LEK)</i></li> <li>• 150 LEK për shumat nga 75,000 LEK deri në 300,000 LEK <i>(të gjitha monedhat)</i></li> <li>• 150 LEK për shumat nga 300,000 LEK deri në 1,500,000 LEK <i>(të gjitha monedhat)</i></li> <li>• 0.10% (max. 2,000 LEK) për shumat mbi 1,500,000 LEK <i>(të gjitha monedhat)</i></li> </ul>	
Tërheqje parash në sportelet e Bankës nga llogaria rrjedhëse e lidhur me Depozitën me Afat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 150 LEK për shumat deri në 75,000 LEK <i>(vetëm për tërheqjet në LEK)</i></li> <li>• 150 LEK për shumat deri në 1,500,000 LEK <i>(të gjitha monedhat)</i></li> <li>• 0.10% (max. 2,000 LEK) për shumat mbi 1,500,000 LEK <i>(të gjitha monedhat)</i></li> </ul>	
Depozitime cash në sportelet e bankës për pagesë kësti kredie, kartë krediti ose Visa Black		Falas
Depozitime cash në sportelet e bankës për llogari personale rrjedhëse		Falas
Depozitime cash nga pale të treta në llogari rrjedhëse <i>(Llogaria mund të jetë individ/ biznes)</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 150 LEK për shumat deri në 150,000 LEK <i>(për depozitime në të gjitha monedhat)</i></li> <li>• 750 LEK për shumat mbi 1,500,000 LEK <i>(për depozitime në të gjitha monedhat)</i></li> </ul>	
Depozitime cash nga klient rastit në një llogari rrjedhëse <i>(Llogaria mund të jetë individ/ biznes)</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 500 LEK për shumat deri në 1,500,000 LEK <i>(për depozitime në të gjitha monedhat)</i></li> <li>• 1,000 LEK për shumat mbi 1,500,000 LEK <i>(për depozitime në të gjitha monedhat)</i></li> </ul>	
Pagesa faturash: • Cash	• Cash 200 LEK	
Pagesa nëpërmjet debitimit direkt		Falas
Konfirmim bankar për marrëdhënie me bankën dhe për balancën e llogarisë		1,000 LEK <i>(Opsionale, sipas kërkesës së klientit)</i>
<b>Interes për depozitimet</b>		
Interes Kreditor në Llogari Rrjedhëse		N/A

### Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

#### Tërheqja nga Kontrata

Nëse klienti ka vetëm një llogari në bankë dhe e mbyll atë brenda 3 muajve, klienti do të paguaj një komision prej 30 EUR.

#### Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Në rast të ndryshimit të ndonjë ose të gjitha kushteve ekonomike të marrëveshjes, atëherë njoftimi nga ana e Bankës, do të konsiderohet i përbushur, nëse realizohet duke përdorur një nga format e mëposhtme të përgjdhura nga Klienti: (i) me shkrim dërguar në adresën personale të postës, ose (ii) në formë elektronike nëpërmjet mesazhit të dërguar me e-mail apo telefon në adresën ose numrin e kontaktit të deklaruar nga Klienti në Bankë.

#### Ankesat

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: [complain@intesasnpaolobank.al](mailto:complain@intesasnpaolobank.al)
- Në Qendrën e Kontaktit : 08006000

Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

## Fjalorth i termave

---

**Specimen** - Specimeni i nenshkrimit, eshte nje dokument i dedikuar ku personat qe jane te autorizuar te administrojne osete nenshkruajne per nje llogari, do te depozitojne nenshkrimet e tyre ne banke. Bazuar ne nenshkrimin e depozituar, Banka do te lejoje disponimin e llogarise sipas urdhrave te personave te autorizuar te Klientit.

**ASD**- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionete saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".